



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE
NACRT ZAKONA O ZAŠTITI OD NASILJA U PORODICI
DRAFT LAW ON PROTECTION AGAINST DOMESTIC VIOLENCE



| REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI | REPUBLIKA KOSOVO SKUPŠTINA | REPUBLIC OF KOSOVO ASSEMBLY |
|---|---|--|
| <p>Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton</p> | <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja</p> | <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of Republic of Kosovo,</p> <p>Promulgates</p> |
| <p>LIGJIN PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE</p> | <p>ZAKON O ZAŠTITI OD NASILJA U PORODICI</p> | <p>LAW ON PROTECTION AGAINST DOMESTIC VIOLENCE</p> |
| <p>I. Dispozitat e përgjithshme</p> | <p>I. Opšte odredbe</p> | <p>I. General Provisions</p> |
| <p>Neni 1 Qëllimi i ligjit</p> | <p>lan 1 Cilj zakona</p> | <p>Article 1 Purpose of the Law</p> |
| <p>1. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja nga dhuna në familje me anë të masave të posaçme ligjore, krijimin e mekanizmave adekuat për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.</p> <p>2. Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.</p> | <p>1. Cilj ovog zakona je zaštita od nasilja u porodici pomo u posebnih zakonskih mera, stvaranje adekvatnih mehanizama za zaštitu, podršku i rehabilitaciju žrtava, utvrđivanje postupka sa po inicijama nasilja u porodici i ublažavanje posledica.</p> <p>2. Ovaj zakon, takodje ima za cilj i tretiranje izvršilaca nasilja u porodici i ublažavanje posledica.</p> | <p>1. The purpose of the present Law is protection from domestic violence through special legal measures, establishment of adequate protection mechanisms, support and rehabilitation of victims.</p> <p>2. This Law, also aims, treatment for perpetrators of domestic violence and mitigation of consequences.</p> |
| <p>Neni 2 Përkufizimet</p> | <p>lan 2 Definicije</p> | <p>Article 2 Definitions</p> |
| <p>1. Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e</p> | <p>1. U svrhe ovog zakona, dole upotrebljeni</p> | <p>1. For the purpose of this Law, the</p> |



| | | |
|--|--|--|
| <p>përdorura në vijim kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. “Marrëdhënie Familjare” konsiderohen personat nëse:</p> <p>1.1.1. janë të fejuar apo ishin të fejuar;</p> <p>1.1.2. janë të martuar apo ishin të martuar;</p> <p>1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;</p> <p>1.1.4. bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;</p> <p>1.1.5. përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;</p> <p>1.1.6. janë prindër të një fëmije të përbashkët;</p> <p>1.1.7 janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare;</p> <p>1.2. “Dhunë ne familje” nënkupton një</p> | <p>izrazi imaju slede e zna enje:</p> <p>1.1. “U porodi nij vezi ” smatraju se lica:</p> <p>1.1.1. ako su vereni ili su bili vereni;</p> <p>1.1.2. ako su ven ani ili su bili ven ani;</p> <p>1.1.3. ako su vanbra ni supružnici ili su živeli u vanbra noj zajednici;</p> <p>1.1.4. ako žive u zajedni kom doma instvu ili su živeli u takvom doma instvu;</p> <p>1.1.5. ako koriste zajedni ki ku u ili su u krvnoj vezi, u braku, usvojeni, pastorci ili su u starateljskom odnosu, uklju uju i roditelje, dedu i babu, decu, unuke, bra u i sestre, tetke, ujake ili ro ake;</p> <p>1.1.6. ako su roditelji zajedni kog deteta;</p> <p>1.1.7. ako su strane u sporu u vezi porodi nog odnosa;</p> <p>1.2. “Nasilje u porodici” predstavlja jedno</p> | <p>following terms shall have the meaning assigned as follows:</p> <p>1.1. “Family Relationship” is considered to exists amongst persons if they:</p> <p>1.1.1. Are engaged or were engaged;</p> <p>1.1.2. Are married or were married;</p> <p>1.1.3. Are in extra martial union or were in extra marital union;</p> <p>1.1.4. Are cohabiting in a common household or were cohabiting in such a household;</p> <p>1.1.5. Use a common house and are in connection by blood, marriage, or adoption, in-law or are in a guardian relationship, including parents, grandparents, children, grandchildren, nephews, nieces, siblings, aunts, uncles or cousins;</p> <p>1.1.6. Are parents of a common child;</p> <p>1.1.7. Are procedural parties in a dispute of family relationship.</p> <p>1.2. “Domestic Violence” means one or</p> |
|--|--|--|



| | | |
|--|---|---|
| <p>ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:</p> <p>1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;</p> <p>1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;</p> <p>1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;</p> <p>1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;</p> <p>1.2.5. ofendimi, sharja, thirja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;</p> <p>1.2.6. perseritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të peruljes së personit tjetër;</p> <p>1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;</p> | <p>ili više namernih dela ili postupaka koje jedno lice izvrši nad drugim licem sa kojim je ili je bio u porodi nom vezi, kao što su, ali se odnosi samo na:</p> <p>1.2.1. koriš enje fizi ke ili psihi ke prinude protiv drugog lana porodice;</p> <p>1.2.2 takvo drugo delo lana porodice koje može da nanese, ili preti da e da nanese fizi ki ili psihi ki bol;</p> <p>1.2.3. izazivanje ose anja straha, opasnosti ili ugrožavanje digniteta;</p> <p>1.2.4. fizi ki napad bez obzira na posledice;</p> <p>1.2.5. vre anje, zlostavljanje, nazivanje pogrđnim imenima i drugi na ini grubog uznemiravanja;</p> <p>1.2.6. stalno ponavljanje ponašanja sa ciljem ponižavanja drugog lica;</p> <p>1.2.7. seksualni odnos i seksualno maltretiranje bez saglasnosti;</p> | <p>more of the following intentional acts or ommisions when committed by a person against another person whith whom he or she is or has been in a domestic relationship, but not limited to:</p> <p>1.2.1.use of physical force or psychological preasure towards another member of the family;</p> <p>1.2.2. any other action of a family member, which may inflict or threaten to inflict physical pain or psychological suffering;</p> <p>1.2.3.causing the other person to fear for personal wellbeing or threat to is/her dignity;</p> <p>1.2.4. physical assault regardless of consequences;</p> <p>1.2.5. insult, offence, calling by offensive names and other forms of violent intimidation;</p> <p>1.2.6. repetitive behaviour with the aim of derogating the other person;</p> <p>1.2.7. non-consensual sexual acts and sexual exploitation;</p> |
|--|---|---|



| | | |
|---|---|---|
| <p>1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;</p> <p>1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;</p> <p>1.2.10. vënja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike;</p> <p>1.2.11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;</p> <p>1.2.12. rrëmbimi.</p> <p>1.3. “Pala e mbrojtur” nënkupton personin ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit të tij/saj në dobi të të cilit është kërkuar urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente ose urdhëri për mbrojtjen e përkohëshme emergjente.</p> <p>1.4. “Kërkesë” nënkupton aktin me të cilin kërkohet mbrojtja nga dhuna në familje.</p> <p>1.5. “Kryerësi i dhunës në familje” nënkupton personin, i cili ka kryer një apo</p> | <p>1.2.8. protivzakonito ograničavanje slobode kretanja drugog lica;</p> <p>1.2.9. oštećenje ili uništavanje imovine i zastrašivanje da e to biti urađeno;</p> <p>1.2.10. dovođenje drugog lica u situaciju da se ono boji za svoje fizičko, emocionalno i ekonomsko stanje;</p> <p>1.2.11. ulazanje ili istupanje uz korišćenje nasilja iz zajedničkog stana ili stana drugog lica;</p> <p>1.2.12. otmica.</p> <p>1.3. “Šti ena strana” zna i lice protiv kojeg je vršeno nasilje u porodici i njegovog/njenog podređenog u kome se koristi zahtevan nalog za zaštitu, nalog za hitnu zaštitu ili privremeni nalog za zaštitu.</p> <p>1.4. “Zahtev” je akt kojim se traži zaštita od nasilja u porodici.</p> <p>1.5. “Izvršilac nasilja u porodici” je lice koje je izvršilo jednom ili više puta nasilje</p> | <p>1.2.8. unlawfully limiting the freedom of movement of the other person;</p> <p>1.2.9. property damage or destruction or threatening to do this;</p> <p>1.2.10. causing the other person to fear for his or her physical, emotional or economic wellbeing;</p> <p>1.2.11. forcibly entering the property of the other person or forcibly removing the other person from a common residence;</p> <p>1.2.12. kidnapping.</p> <p>1.3. “Protected Party” means a person subjected to domestic violence and his/her subordinate for whose benefit a protection order, an emergency protection order or temporary emergency order is sought.</p> <p>1.4. “Petition” is the act through which protection from domestic violence is sought.</p> <p>1.5. “Perpetrator” means a person who is has committed an act or acts of domestic</p> |
|---|---|---|



| | | |
|--|--|--|
| <p>me tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente. ose urdhëri për mbrojtjen e përkohëshme emergjente.</p> <p>1.6. “Viktimë” nënkupton personin i cili i është nënshtruar dhunës në familje.</p> <p>1.7. “Përfaqësuesi i autorizuar” nënkupton personin, i cili është i autorizuar për të mbrojtur interesat e palës së mbrojtur, dhe për t’iu siguruar përkrahje e ndihmë viktimave.</p> <p>1.8. “Mbrojtësi i viktimave” nënkupton personin e autorizuar zyrtar i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicon procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha sencat gjyqësore, të monitoroj mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.</p> <p>1.9. “Urdhër mbrojtje” nënkupton urdhërin e lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.</p> <p>1.10. “Urdhër mbrojtje emergjente”</p> | <p>u porodici, protiv kojeg se zahteva izdavanje naloga za zaštitu, nalog za hitnu zaštitu ili nalog za privremenu hitnu zaštitu.</p> <p>1.6. “Žrtva” je lice koje je bilo izloženo nasilju u porodici.</p> <p>1.7. “Ovlaš eni predstavnik” je lice koje je ovlaš eno da štiti interese štine strane i za obezbeivanje podrške i pomoći žrtvama.</p> <p>1.8. “Štiti enik žrtava” zna i službeno ovlaš eno lice koji neposredno pomaže oštećenu stranu od prvih kontakata sa nadležnim zaštitnim organima, savetuje, pokreće i postupa za određivanje zaštitnih mera, obavezan je da učestvuje na svim sudskim raspravama, da nadgleda odvijanje sudskog procesa</p> <p>1.9. “Nalog za zaštitu” je nalog izdat sudskom odlukom gde su predviđene zaštitne mere prema žrtvi.</p> <p>1.10. “Nalog za hitnu zaštitu” je nalog</p> | <p>violence and against whom a protection order, an emergency protection or temporary protection order is sought.</p> <p>1.6. “Victim” means a person who was subjected to domestic violence.</p> <p>1.7. “Authorized Representative” means the person who is authorized to advocate the victims’s interests and to provide support and assistance to victims, including the victim’s protector.</p> <p>1.8. “Protection of victims” means the official authorized person who directly protects the damaged party since the first contact with competent protection authorities, advises, initiates procedures for imposing protection measures, is obliged to participate in all judicial sessions, to monitor the progress of the judicial process.</p> <p>1.9. “Protection order” is an order issued by a court providing protection measures for the victim.</p> <p>1.10. “Emergency protection order” is a</p> |
|--|--|--|



| | | |
|--|--|--|
| <p>nënkupton urdhërin e lëshuar përkohësisht me vendim gjykate.</p> <p>1.11. “Urdhër mbrojtje e përkohshme emergjente” nënkupton urdhërin e lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Juridiksioni i Gjykatës, organet kompetente dhe masat mbrojtëse</p> <p>1. Gjykata Komunale e cila e ka juridiksionin në komunën ku parashtruesi i kërkesës ka vendbanimin apo vendqëndrimin, është kompetente për shqiptimin e masave mbrojtëse.</p> <p>2. Çdo gjykatë komunale është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhërin, nëse gjykata kompetente sipas paragrafit 1 të këtij neni e ka paraqitur kërkesën për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente në atë gjykatë dhe nëse ajo gjykatë ka juridiksion në komunën në të cilën pala e mbrojtur e ka ndërruar vendbanimin apo vendqëndrimin, apo nëse</p> | <p>privremeno izdat sudskom odlukom.</p> <p>1.11. “Nalog za privremenu hitnu zaštitu” je nalog izdat van radnog vremena sudova.</p> <p style="text-align: center;">lan 3 Jurisdikcija suda, nadležni organi i zaštitne mere</p> <p>1. Opštinski sud koji ima jurisdikciju u opštini gde podnosioc zahteva živi ili gde mu je boravište ili prebivalište je nadležan za donošenje zaštitnih mera.</p> <p>2. Svaki opštinski sud je nadležan da razmotri zahtev za zaštitu ili hitnu zaštitu i da izda nalog, ako je nadležni sud, po stavu 1 ovog lana podneo zahtev za zaštitu ili hitnu zaštitu tom sudu i ako taj sud ima jurisdikciju u opštini gde je zašti ena strana promenila mesto prebivališta ili boravistašta, ili ako ta promena služi najboljem interesu zašti ene strane.</p> | <p>temporary court order valid until the court issues a protection order.</p> <p>1.11. “Temporary Emergency Protection Order” is a order issued outside working hours of courts, which is valid until the end of the next day that the court is in operation.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Court Jurisdiction, Competent Authorities and Protection Measures</p> <p>1. The municipal court that has the jurisdiction at the municipality where the applicant is temporarily or permanently residing or staying shall be competent to issue protection measures.</p> <p>2. Every municipal court shall have the authority to review the request for protection order or emergency protection order and for issuing the order, if the competent court as per paragraph 1 of the present Article has filed a request for protection order or emergency protection order and if that court has jurisdiction at the municipality where the protected party has changed his/her place of residence or stay or if this transfer serves to the best</p> |
|--|--|--|



| | | |
|---|---|---|
| <p>kjo bartje i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur.</p> <p>3. Nëse në gjykatën kompetente është parashtruar kërkesa në bazë të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, e njejta gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente dhe për të shqiptuar urdhërin.</p> <p>4. Masat mbrojtëse shqiptohen me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, për mbrojtjen e personit që i është ekspozuar dhunës, duke mënjanuar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave tjera.</p> <p>5. Gjykata komunale kompetente, me urdhërmbrojtje apo me urdhërmbrojtje emergjente mund të shqiptojë një apo më tepër masa mbrojtëse.</p> <p>6. Organ kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse është Policia e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p style="text-align: center;">Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial</p> <p>1. Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund ti shqiptohet kryesit të</p> | <p>3. Ako je zahtev podnet nadležnom sudu, na osnovu Kosovskog Zakona br. 2004/32, isti je sud nadležan da razmotri zahtev za zaštitu po nalogu ili zahtev za hitnu zaštitu i da izda nalog.</p> <p>4. Zaštitne mere donose se sa ciljem zaštite od nasilja u porodici, za zaštitu lica koje je izloženo nasilju, u cilju otklanjanja okolnosti koje uti u, ili mogu da uti u na izvršavanje drugih dela.</p> <p>5. Opštinski nadležni sud putem naloga za zaštitu, ili naloga za hitnu zaštitu može da donese jednu ili više zaštitnih mera.</p> <p>6. Nadležni organ za sprovođenje zaštitnih mera je Policija Kosova.</p> <p style="text-align: center;">lan 4</p> <p style="text-align: center;">Zaštitna mera psihosocijalnog leenja</p> <p>1. Obavezna zaštitna mera psihosocijalnog leenja može da bude izrečena izvršiocu</p> | <p>interest of the protected party.</p> <p>3. If at the competent court, the pleading has been filed according to the Law No. 2004/32 on Family Law of Kosovo, the same court shall be competent to review the request for protection order or emergency protection order as well as to issue the order.</p> <p>4. Protection measures shall be issued with the purpose of preventing domestic violence, to protect a person who is exposed to violence, by removing the circumstances which impact or may impact in committing other acts.</p> <p>5. The competent municipal court, through protection order or emergency protection order, may impose one or more protection measures.</p> <p>6. Competent body for the execution of protection measures shall be the Kosovo Police.</p> <p style="text-align: center;">Article 4</p> <p style="text-align: center;">Protection Measure of Psycho-Social Treatment</p> <p>1. The protection measure for psycho-</p> |
|---|---|---|



| | | |
|--|--|---|
| <p>dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër, me qëllim të mënjanimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje.</p> <p>2. Masa nga paragrafi 1 i këtij neni, zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj.</p> <p>3. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Shëndetësi dhe institucionet përkatëse përgatisin dhe propozojnë për aprovim në Qeveri aktin nënligjor me të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial.</p> | <p>nasilja u porodici, u kombinacija sa nekom drugom megom, sa ciljem eliminacije nasilnog ponašanja izvršioca, ili ako postoji rizik od ponavljanja dela nasilja u porodici.</p> <p>2. Mera iz stava 1 ovog lana traje sve dok ne prestanu da postoje razlozi zbog kojih je izre ena mera, ali ne može da traje duže od šest meseci.</p> <p>3. Odgovorno Ministarstv za rad socijalnu zaštitu, u saradnji sa odgovornim ministarstvom za zdravlje pripremeamju i predlažu za usvajanje u Vladi, podzakonski akt kojim e utvrditi na in i mesto sprovo enja psihosocijalnog le enja.</p> | <p>social treatment may be issued for a perpetrator of domestic violence in combination with any other measure with the aim of preventing violent behaviours of the perpetrator or if there is a risk to repeat the domestic violence act.</p> <p>2. The measure from paragraph 1 of this Article continues until the causes on basis of which it was issued cease to exist, but may not continue more than six months.</p> <p>3. Ministry responsible for Labor and Social Welfare in cooperation with the Ministry responsible for Health and other relevant institutions prepare and propose for approval to the Government the issuance of a sub-legal act to determine the ways and location of implementation of psycho-social treatment.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 5 Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktims së dhunës në familje</p> | <p style="text-align: center;">lan 5 Zaštitna mera zabrane približavanja žrtvama nasilja u porodici</p> | <p style="text-align: center;">Article 5 Protection Measures of Restraining Orders</p> |
| <p>1. Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktims së dhunës në familje si dhe vartësit të tij/saj dhe personave tjerë nëse është e nevojshme, mund t'i shqiptohet personit i cili ka kryer dhunë në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së</p> | <p>1. Zaštitna mera zabrane približavanja žrtvi nasilja u porodici, kao i nje govom/njenom podredjenom i drugim licima, ako je to potrebno može da bude izre ena licu koje je izvršilo nasilje u porodici, ako postoji rizik da se ponovi to delo.</p> | <p>1. Protective measures of restraining order of domestic violence victim and his/her subordinate and other persons if necessary, may be issued to a person who has committed domestic violence, if there is a risk for the violence to be repeated.</p> |



| | | |
|---|---|---|
| <p>dhunës në familje.</p> <p>2. Në urdhërin me të cilin shqiptohet masa e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje, gjykata cakton vendin, regjionin dhe largësinë, brenda së cilës kryerësi nuk guxon t'i afrohet viktimës së dhunës në familje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës</p> <p>1. Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit në përputhshmëri me përkufizimin e dhënë në nenin 2 paragrafi 1.2, të këtij ligji, mund t'i shqiptohet kryerësit të dhunës në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.</p> <p>2. Kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryerësit të dhunës në familje.</p> | <p>2. U nalogu kojim se izri e mera zabrane približavanja žrtvi nasilja u porodici, sud utvr uje mesto, region i daljinu unutar koje izvršilac ne sme da se približi žrtvi nasilja u porodici.</p> <p style="text-align: center;">lan 6 Zaštitna mera zabrane uznemiravanja lica izloženih nasilju</p> <p>1. Zaštitna mera zabrane uznemiravanja u skladu sa definicijom datoj u lanu 2 stav 1.2 ovog zakona može da bude izre ena izvršiocu nasilja u porodici ako postoji rizik od ponavljanja nasilja u porodici.</p> <p>2. Starateljstvo nad detetom privremeno se poverava žrtvi nasilja u porodici, a roditeljsko pravo se privremeno oduzima izvršiocu nasilja u porodici.</p> | <p>2. In the restraining order, the Court defines the location, region and distance within which the perpetrator cannot approach the victim of domestic violence.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Protection Measures of Prohibition of Harassment to Persons Exposed to Violence</p> <p>1. Protective measure of prohibition of harassment, in compliance with the definition provided in article 2 paragraph 1.2. of this law may be imposed to a perpetrator of domestic violence, where there is a risk for the violence to be repeated.</p> <p>2. The temporary child custody shall be entrusted to the victim of domestic violence, while the parental right temporary shall be removed from the perpetrator of domestic violence.</p> |
|---|---|---|



| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 7</p> <p style="text-align: center;">Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit</p> <p>1. Masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, i shqiptohet personit që ka kryer dhunë ndaj anëtarit të familjes me të cilin jeton në banesë, shtëpi apo ndonjë hapësirë tjetër banimi, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.</p> <p>2. Personi të cilit i është shqiptuar masa nga paragrafi 1. i këtij neni, obligohet menjëherë t'a lëshoj banesën, shtëpinë apo hapësirën tjetër të banimit, në prezencë të zyrtarit policor.</p> | <p style="text-align: center;">lan 7</p> <p style="text-align: center;">Zaštitna mera udaljavanja iz stana, ku e ili drugog stambenog prostora</p> <p>1. Zaštitna mera udaljavanja iz stana, ku e ili drugog stambenog prostora, može da bude izre ena licu koje je izvršilo nasilje u porodici nad lanom porodice sa kojim živi u stanu, ku i ili bilo kom drugom stambenom prostoru, ako postoji rizik od ponavljanja nasilja u porodici.</p> <p>2. Lice kojem je izre ena mera iz stava 1. ovog lana, obavezno je da odmah napusti stan, ku u ili drugi stambeni prostor, u prisustvu policijskog službenika.</p> | <p style="text-align: center;">Article 7</p> <p style="text-align: center;">Protection Measures of Removal from Apartment, House or other Living Premises</p> <p>1. Removal from the apartment, house or other living premise may be imposed to a person who has committed violence against a member of the family sharing the same apartment, house or living premise if there is a risk to repeat domestic violence.</p> <p>2. A person who has been imposed measures as per paragraph 1. of the present article is immediately obliged to leave the apartment, house or other living premise, at the presence of a police officer.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p style="text-align: center;">Masa mbrojtëse e shoqërimit viktimës së dhunës</p> <p>1. Masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës, mund të shqiptohet me qëllim të mbrojtjes gjatë marrjes së gjësendeve personale.</p> <p>2. Masa nga paragrafi 1. i këtij neni zbatohet nën shoqërimit të zyrtarit policor.</p> | <p style="text-align: center;">lan 8</p> <p style="text-align: center;">Zaštitna mera pra enja žrtava nasilja</p> <p>1. Zaštitna mera pra enja žrtava može da bude izre ena sa ciljem zaštite u toku uzimanja li nih stvari.</p> <p>2. Mera iz stava 1. ovog lana sprovodi se u prisustvu policijskog službenika.</p> | <p style="text-align: center;">Article 8</p> <p style="text-align: center;">Protection Measure of Accompanying Victims of Violence</p> <p>1. Accompanying victims may be imposed with the purpose of protection during collection of personal items.</p> <p>2. Measure from paragraph 1. of this article are imposed under accompaniment of a police officer.</p> |



| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 9 Masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope</p> <p>1. Masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope i shqiptohet personit, i cili ka kryer dhunë në familje nën ndikimin e tyre, kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.</p> <p>2. Ministria përgjegjëse për Shëndetësi nxjerr akt nënligjor, për mënyrën e trajtimit të personave ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.</p> | <p style="text-align: center;">lan 9 Zaštitna mera obaveznog le enja od zavisnosti od alkohola i psihotropnih supstanci</p> <p>1. Zaštitna mera obaveznog le enja od zavisnosti od alkohola i psihotropnih supstanci, može da bude izre ena licu koje je izvršilo nasilje u porodici pod uticajem alkohola ili psihotropnih supstanci, kada postoji rizik od ponavljanja nasilja u porodici.</p> <p>2. Odgovorno Ministarstvo za zdravlje e doneti podzakonski akt o na inima tretiranja lica prema kojima je izre ena zaštitna mera obavezuju eg medicinskog tretiranja zavisnosti od alkohola i psihotropskih supstanci.</p> | <p style="text-align: center;">Article 9 Protection measures medical treatment for alcohol dependency and dependency from psychotropic substances</p> <p>1. Mandatory medical treatment from alcohol and psychotropic substance dependency may be imposed to a person who has committed domestic violence under influence, where there is a risk to repeat domestic violence.</p> <p>2. Ministry responsible for Health shall issue subsidiary legislation, for the treatment manner of persons to whom is imposed mandatory treatment from alcohol and psychotropic substances dependency.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 10 Masa mbrojtëse e marrjes së sendit</p> <p>1. Masa mbrojtëse e marrjes së sendit me të cilin është kryer vepra, apo sendeve me të cilat dyshohet se mund të përsëritet dhuna në familje, shqiptohet me qëllim të mbrojtjes së personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje apo e personave tjerë.</p> | <p style="text-align: center;">lan 10 Zaštitna mera oduzimanja predmeta</p> <p>1. Zaštitna mera oduzimanja predmeta kojim je izvršeno delo, ili predmeta za koje postoji sumnja da može da se upotrebi za ponavljanje dela, izri e se sa ciljem zaštite lica nad kojim je izvršeno nasilje u porodici ili drugih lica.</p> | <p style="text-align: center;">Article 10 Protection Measures of Confiscation of Items</p> <p>1. Confiscation of items by means of which the act of violence was committed, or items by means of which the act of violence is suspected to be repeated, is imposed with the aim of protection of person against which domestic violence has been committed or other persons.</p> |



| | | |
|---|--|--|
| <p>2. Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Masat mbrojtëse pasurore</p> <p>1. Gjykata, krahas masave të parapara në nenet 4 deri 10 të këtij ligji, mund të shqiptoj edhe masat si në vijim:</p> <p>1.1. urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku ose ndonjë pjesë të saj;</p> <p>1.2. urdhërimi i kryerësit të dhunës në familje që të paguajë qiranë e banesës së përkohshme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për fëmijë, për të cilin kryerësi i dhunës në familje ka obligim për ta mbajtur;</p> <p>1.3. ndalimi i kryerësit të dhunës në familje ose palës së mbrojtur, bartjen si dhe çdo lloj transaksioni të çfarëdo pasurie brenda një periudhe të caktuar kohore;</p> | <p>2. Zaštitna mera iz stava 1 ovog lana izri e se primenjuje u skladu sa Krivi nim zakonom Kosova.</p> <p style="text-align: center;">lan 11 Imovinske zaštitne mere</p> <p>1. Pored mera iz lanova 4 do 10 ovog zakona, sud može da donese i slede e mere:</p> <p>1.1. nalog kojim se izvršiocu nasilja u porodici nalaže da omogu i štinoj strani da koristi stan koji zajedno koriste ili bilo koji njegov deo;</p> <p>1.2. nalog kojim se izvršiocu nasilja u porodici nalaže da pla a kiriju za privremeni stan u kojem živi štino lice, ili da pla a alimentaciju štinoj strani i za bilo koje dete, prema kojem izvršilac nasilja u porodici ima obavezu izdržavanja;</p> <p>1.3. zabrana izvršiocu nasilja ili štinoj strani da prodaju bilo šta od imovine u utvr enom vremenskom periodu;</p> | <p>2. Protection measure from paragraph 1 of this article are implemented in accordance with the Kosovo Criminal Code.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Property Protection Measures</p> <p>1. The Court, in addition to measures envisaged under articles 4 to 10 of the present law, may impose the following measures:</p> <p>1.1. ordering the perpetrator to allow the protected party to use living premises shared, or a part of the premises;</p> <p>1.2. ordering the perpetrator to pay for rent of temporary living premises of the protected party or to pay alimony to the protected party and any children, for which the domestic violence perpetrator has an obligation to support;</p> <p>1.3. prohibiting the perpetrator or the protected party to sell any assets within a determined period of time;</p> |
|---|--|--|



| | | |
|--|---|---|
| <p>1.4. ofrimi i mundësisë palës së mbrojtur, që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të saj;</p> <p>1.5. caktimi i ndonjë mase tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;</p> <p>1.6. t'i urdhërohet kryerësit të dhunës në familje që palës së mbrojtur t'i lejohet kthimi në shtëpi.</p> <p>2. Kryerësi i dhunës në familje, ka të drejtë që me shoqërimin e policisë t'i marrë gjërat e tij personale.</p> <p>3. Masat mbrojtëse të parapara në nenet 4,5,6,7,8,9,10,11 shqiptohen në pajtim me kohëzgjatjen e urdhërit mbrojtës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Ndërlidhja me urdhërat e tjerë</p> <p>1.Pavarësisht prej ndonjë urdhëri tjetër të shqiptuar nga gjykata apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo organ tjetër</p> | <p>1.4. obezbe ivanje mogu nosti ští enoj strani da samo ona poseduje i koristi odre enu li nu imovinu;</p> <p>1.5. utvr ivanje bilo koje druge mere koja je potrebna za zaštitu bezbednosti, zdravlja ili dobrobiti ští ene strane ili lica sa kojima je ští ena strana u porodi noj vezi;</p> <p>1.6. donošenje naloga kojim se izvršiocu nasilja u porodici nalaže da ští enoj strani dozvoli povratak ku i.</p> <p>2. Izvršilac nasilja u porodici ima pravo da u prisustvu policije uzme svoje li ne stvari.</p> <p>3. Zaštitne mere, predviđene u lanu 4,5,6,7,8,9,10,11 izri u se u skladu sa trajanjem zaštitnog naloga.</p> <p style="text-align: center;">lan 12 Veza za ostalim nalozima</p> <p>1. Nezavisno od bilo kojeg drugog naloga izdatog of suda ili drugog rešenja izdatog od suda ili drugog nadležnog organa, nalog</p> | <p>1.4. offering the possibility to the protected party to exclusively possess and use its assigned personal assets;</p> <p>1.5. imposing any other measures that are necessary to protect the safety, health or welfare of the protected party or person the protected party is in a domestic relationship with;</p> <p>1.6. to order the perpetrator to allow the protected party to return to the household.</p> <p>2. The perpetrator has the right to collect personal belongings in the presence of police officers.</p> <p>3. Protective measures foreseen in articles 4,5,6,7,8,9,10,11 are issued in accordance with the duration of the protective measures.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Relation to other Orders</p> <p>1. Regardless of any other order issued by the court or any competent body, the protection order, emergency protection</p> |
|--|---|---|



| | | |
|--|--|---|
| <p>kompetent, urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente ose urdhëri për mbrojtje emergjente të përkohëshme mund të shqiptohet në përputhje me këtë ligj.</p> <p>2. Shqiptimi i urdhërit për mbrojtje, urdhërit për mbrojtje emergjente ose urdhërit për mbrojtje emergjente të përkohëshme nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhërit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Kërkesat për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente</p> <p>1. Kërkesën për urdhërmbrojtje mund ta paraqesë:</p> <p>1.1. pala e mbrojtur;</p> <p>1.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;</p> <p>1.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;</p> <p>1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri.</p> | <p>za zaštitu, nalog za hitnu zaštitu ili nalog za privremenu hitnu zaštitu može se izdati u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>2. Izdavanje naloga za zaštitu, naloga za hitnu zaštitu ili naloga za privremenu zaštitu ne gazi imovinsko ili starateljsko pravo nijednog lica posle isteka roka naloga.</p> <p style="text-align: center;">lan 13 Zahtev za donošenje naloga za zaštitu ili naloga za hitnu zaštitu</p> <p>1. Zahtev za donošenje naloga za zaštitu može da podnese:</p> <p>1.1. ští ena strana;</p> <p>1.2. ovlaš eni predstavnik ští ene strane;</p> <p>1.3. zaštitnik žrtava, posle saglasnosti ští ene strane;</p> <p>1.4 predstavnik centra za socijalni rad u opštini u kojoj ští ena strana ima boravište ili prebivalište u slu ajevima u kojima je žrtva maloletnik</p> | <p>order or temporary emergency protection order may be issued in compliance with the present Law.</p> <p>2. Issuance of a protection order, emergency protection order or temporary emergency protection order shall not infringe the property or custodian rights of any person following its expiry.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Petitions for Protection Orders or Emergency Protection Orders</p> <p>1. A petition for protection orders may be filed by:</p> <p>1.1. the protected party;</p> <p>1.2. an authorized representative of the protected party;</p> <p>1.3. a victim advocate, upon consent of the protected party;</p> <p>1.4. representative social welfare centre in the municipality where the protected party permanently or temporary resides in cases where the</p> |
|--|--|---|



| | | |
|--|---|--|
| <p>2. Kërkesën për urdhërbrojtje emergjente mund ta paraqesë:</p> <p>2.1. pala e mbrojtur;</p> <p>2.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;</p> <p>2.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;</p> <p>2.4. personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;</p> <p>2.5. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;</p> <p>2.6. personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Formulari i kërkesës për urdhërbrojtje ose urdhërbrojtje emergjente</p> <p>1. Kërkesa për urdhërbrojtje ose</p> | <p>2. Zahtev za donošenje naloga za hitnu zaštitu može da podnese:</p> <p>2.1. ští ena strana;</p> <p>2.2. ovlaš eni predstavnik ští ene strane;</p> <p>2.3. zaštitnik žrtava, posle saglasnosti ští ene strane;</p> <p>2.4. lice sa kojim je ští ena strana u porodi noj vezi;</p> <p>2.5. predstavnik centra za socijalni rad u opštini u kojoj ští ena strana ima prebivalište ili boravište u slu ajevima u kojima je žrtva maloletnik;</p> <p>2.6. lice koje ima neposredno saznanje o jednom ili više dela nasilja u porodici nad ští enom stranom.</p> <p style="text-align: center;">lan 14 Na in podnošenja zahteva za donošenje naloga za zaštitu ili naloga za hitnu zaštitu</p> <p>1. Zahtev za donošenje naloga za zaštitu</p> | <p>victim is minor.</p> <p>2. A petition for emergency protection orders may be filed by:</p> <p>2.1. the protected party;</p> <p>2.2. an authorized representative of the protected party;</p> <p>2.3. the victim advocate, upon consent of the protected party;</p> <p>2.4. a person with whom the protected party has a domestic relationship;</p> <p>2.5. a representative from the Center for Social Work in the municipality where the protected party permanently or temporarily resides in cases where the victim is minor;</p> <p>2.6. a person with direct knowledge of an act or acts of domestic violence against the protected party.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Petition Form for Protection Order or Emergency Protection Order</p> <p>1. A petition for protection order or emergency protection order shall be filed</p> |
|--|---|--|



| | | |
|--|--|---|
| <p>urdhërmbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht sipas ligjit për procedurën kontestimore dhe përfshinë:</p> <p>1.1. emërtimin e gjykatës;</p> <p>1.2. Emrin, adresën dhe profesionin e kërkuarit dhe të kryerësit të dhunës në familje;</p> <p>1.3. emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili ka kërkuar mbrojtjen për palën ndaj së cilës është ushtruar dhuna, si dhe lidhja familjare e palës me personin i cili ka shkaktuar dhunë në familje;</p> <p>1.4. përshkrimi detal i gjendjes faktike dhe kur është e mundur duhet të bashkangjes edhe provat, si dhe arsyen e kërkesës për shqiptimin e urdhërit mbrojtës ose urdhërit për mbrojtje emergjente;</p> <p>1.5. propozimin e masës mbrojtëse.</p> <p>2. Nëse zbulimi i vendbanimit apo vendqëndrimit të kërkuarit, të palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhërit për mbrojtje</p> | <p>ili naloga za hitnu zaštitu podnosi se u pisanom ili usmenom obliku shodno Zakonu o parni nom postupku, i on sadrži:</p> <p>1.1. naziv suda;</p> <p>1.2. ime, adresu i zanimanje podnosioca zahteva i izvršioca nasilja u porodici;</p> <p>1.3. ime i adresu ští ene strane i lica koje zahteva zaštitu strane nad kojom je izvršeno nasilje, kao i porodi nu vezu ští ene strane sa licem koje je izvršilo nasilje u porodici;</p> <p>1.4. detaljni opis fakti kog stanja i kada je to mogu e treba priložiti i dokaze, kao i obrazloženje zahteva za donošenje naloga za zaštitu ili naloga za hitnu zaštitu;</p> <p>1.5. predlog zaštitnih mera.</p> <p>2. Ako otkrivanje prebivališta ili boravišta podnosioca zahteva, ští ene strane ili lica sa kojim je ští ena strana u porodi noj vezi, koje treba da bude zašti eno donošenjem naloga za zaštitu ili naloga za</p> | <p>in writing or verbally in accordance with the Law on Contentious Procedures, including:</p> <p>1.1. the name of the court;</p> <p>1.2. the name, address and occupation of the petitioner and the perpetrator;</p> <p>1.3. the name and address of the protected party and the person who has petitioned for protection of the party who is to be protected by the protection order and the relationship of such persons to the perpetrator;</p> <p>1.4. a detailed description of the subject matter and, where possible, evidence should be attached as well as the reasons for petitioning to issue a protection order or emergency protection order;</p> <p>1.5. a proposed protection measure.</p> <p>2. If the disclosure of the permanent or temporary address of the petitioner the protected party and/or a person who has a domestic relationship with the protected party and who is to be protected by the</p> |
|--|--|---|



| | | |
|--|---|--|
| <p>ose urdhërit për mbrojtje emergjente, do ta rrezikonte atë person, atëherë mund të merren një apo me tepër veprime, si më mëposhtë:</p> <p>2.1. kërkesa duhet të sigurojë një adresë alternative;</p> <p>2.2. adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës; ose</p> <p>2.3. nëse gjykata vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15</p> <p style="text-align: center;">Shqyrtimi i kërkesave për urdhërmbrojtje</p> <p>1. Gjykata kompetente vendosë përkitazi me kërkesën për urdhërmbrojtje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimit të saj.</p> <p>2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje, gjykata e mban seancën e</p> | <p>hitnu zaštitu, predstavlja rizik po to lice, tada može da bude preduzeta jedna ili više od narednih aktivnosti:</p> <p>2.1. zahtev treba da sadrži i alternativnu adresu;</p> <p>2.2. dodatna adresa u zahtevu treba da bude adresa koja se pojavljuje samo u dokumentima i javnim dosijeima suda; ili</p> <p>2.3. ako sud zaključi i da je objavljivanje adrese u sudskom dosijeu neophodno, taj dosije koji sadrži adresu se drži zatvorenim.</p> <p style="text-align: center;">lan 15</p> <p style="text-align: center;">Razmatranje zahteva za donošenje naloga za zaštitu</p> <p>1. Nadležni sud odlučuje u vezi sa zahtevom za donošenje naloga za zaštitu u roku od petnaest dana od prijema tog zahteva.</p> <p>2. U toku razmatranja zahteva za donošenje naloga za zaštitu, sud održava</p> | <p>protection order or emergency protection order, would endanger such person, the one or more following measures may be taken:</p> <p>2.1. the petition may provide an alternative address;</p> <p>2.2. the alternative address provided in the petition shall be the only address reflected in public court documents and records; or</p> <p>2.3. If the court determines that disclosure of an address in the court records is necessary, the records which reflect that address shall be sealed.</p> <p style="text-align: center;">Article 15</p> <p style="text-align: center;">Review of Petitions for Protection Orders</p> <p>1. The court of competent jurisdiction shall decide on a petition for a protection order within fifteen days of receipt of the petition.</p> <p>2. In reviewing a petition for a protection order, the court shall hold a hearing so that</p> |
|--|---|--|



| | | |
|---|--|---|
| <p>dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat në vijim:</p> <p>2.1. pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave;</p> <p>2.2. kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;</p> <p>2.3. parashtruesi i kërkesës;</p> <p>2.4. përfaqësuesi nga qendra për punë sociale i komunës në të cilin jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:</p> <p>2.4.1. parashtruesi i kërkesës është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose i mungon zotësia e veprimit; ose</p> <p>2.4.2. veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose nuk ka zotësi të veprimit;</p> <p>2.5. dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.</p> <p>3. Dëgjimi dhe shqiptimi bëhet në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur</p> | <p>rasprava kojoj prisustvuju slede a lica:</p> <p>2.1. ští ena strana, ovlaš eni predstavnik ili zaštitnik žrtava;</p> <p>2.2. izvršilac nasilja ili ovlaš eni predstavnik;</p> <p>2.3. podnosilac zahteva;</p> <p>2.4. predstavnik centra za socijalni rad u opštini u kojoj stalno ili privremeno živi dole pomenuto lice u slu aju kada:</p> <p>2.4.1. podnosilac zahteva ima manje od osamnaest (18) godina ili kada je poslovno nesposoban; ili</p> <p>2.4.2. pretpostavljeno delo nasilja u porodici uti e na lice koje je mla e od osamnaest (18) godina ili koje je poslovno nesposobno;</p> <p>2.5. svedoci koje sud smatra potrebnim.</p> <p>3. Rasprava i izricanje se održava u odsustvu izvršioca nasilja u porodici ukoliko je izvršilac nasilja u porodici</p> | <p>the following persons may be heard:</p> <p>2.1. the protected party, an authorized representative or the victims advocate;</p> <p>2.2. the perpetrator and/or an authorized representative;</p> <p>2.3. the petitioner;</p> <p>2.4. a representative from the Center for Social Work of the municipality where the person referred to below permanently or temporarily resides in a case where:</p> <p>2.4.1. the petitioner is under the age of eighteen (18) years or lacks capacity to act; or</p> <p>2.4.2. The alleged acts of domestic violence impact on a person who is under the age of eighteen (18) years or lacks capacity to act;</p> <p>2.5. any witness deemed necessary by the court.</p> <p>3. The hearing and issuance shall be held in the absence of the perpetrator where such individual was properly summoned</p> |
|---|--|---|



| | | |
|---|--|---|
| <p>në menyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftusheme.</p> <p>4. Gjykata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas paragrafit. 2 të këtij neni, në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.</p> <p>5. Kërkesa konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirrë në mënyrën e rregullt, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre.</p> <p>6. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16</p> <p style="text-align: center;">Shqyrtimi i kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente</p> <p>1. Gjykata vendos përkritazi me kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës.</p> | <p>regularno pozvan i ako je zahtev podržan dovoljnim dokazima.</p> <p>4. Sud odmah poziva lica iz stava 2 ovog lana po osnovu Zakona o parni nom postupku.</p> <p>5. Zahtev se smatra povu enim ako se na raspravi ne pojave ni ští ena strana ni ovlaš eni predstavnik ští ene strane, iako su ova lica regularno pozvana, pri emu sud nije obavešten o razlozima njihovog odsustva.</p> <p>6. Povla enje zahteva ne spre ava podnošenje drugog zahteva.</p> <p style="text-align: center;">lan 16</p> <p style="text-align: center;">Razmatranje zahteva za donošenje naloga za hitnu zaštitu</p> <p>1. Sud odlu uje u vezi sa zahtevom za donošenje naloga za hitnu zaštitu u roku od dvadeset etiri (24) sata od prijema tog zahteva.</p> | <p>and the petition is supported by sufficient evidence.</p> <p>4. The court shall immediately summon the persons referred to in paragraph 2 of the present article, in accordance with the Law on Contentious Procedure.</p> <p>5. The petition shall be considered withdrawn if neither the protected party nor the authorized representative of the protected party appear at the hearing, where such persons were properly summoned and did not inform the court of the reasons for their absence.</p> <p>6. The withdrawal of the petition does not prevent the submission of another petition.</p> <p style="text-align: center;">Article 16</p> <p style="text-align: center;">Review of Petitions for Emergency Protection Orders</p> <p>1. The court shall decide on a petition for an emergency protection order within twenty-four (24) hours of the filing of the petition.</p> |
|---|--|---|



| | | |
|---|--|---|
